

Deputet i Kuvendit
Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste



KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

Nr. 223 Prot.

Tiranë më 21/1/2019

Lënda: Kërkesë për shtyrjen e afatit të veprimtarisë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për Realizimin e Reformës Zgjedhore”

Drejtuar:

Z. Gramoz RUÇI
KRYETARI I KUVENDIT

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Me vendimin Nr. 102/2017, datë 13.10.2017, Kuvendi i Shqipërisë vendosi krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për Realizimin e Reformës Zgjedhore”.

Në pikën X të këtij Vendimi, parashikohet që Komisioni do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6 mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

Me Vendimin nr. 58, datë 29.03.2018, Kuvendi vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar Për Reformën Zgjedhore për një periudhë 4 mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

Me vendimin nr. 89, datë 23.07.2018, Kuvendi vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore për një periudhë 6 mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

Me qëllim që veprimtaria e këtij Komisioni të Posaçëm Parlamentar të përmbushë të gjithë objektivat e përcaktuara nga Kuvendi, do të nevojitet më shumë kohë sesa u parashikua në vendimin nr. 89/2018.

Për këtë arsye, kërkojmë që në seancë plenare, Kuvendi të shqyrtojë dhe të miratojë projektvendimin bashkëlidhur për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën Zgjedhore”, për një periudhë 1 (një) mujore.

Me konsideratë,

Taulant Balla

Kryetar i Grupit Parlamentar